- Disponimi i kapaciteteve sipas **pikave 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7, 2.3.9, të kapacitetit teknik**, do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8) gjatë fazës së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.
- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## 2.1 KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

**Lot.2** “Rikonstruksion i disa QSH- ve në rajonet Elbasan dhe Vlorë (12 objekte)” me fond limit **38,223,795.24** (tridhjetë e tetë milion e dyqind e njëzet e tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë .24) lekë pa TVSH;

Tot. Obj.	Nr. Obj	EMËRTIMI I QENDRËS SHËNDËTËSORE/AMB	Bashkia/Njësia administrative
		<b>TOTALI</b>	
<b>12</b>		<b>RAJONI TIRANË</b>	
		<b>QARKU TIRANË</b>	
<b>5</b>		<b>RAJONI ELBASAN</b>	
		<b>QARKU BERAT</b>	
		<b>RRETHI BERAT</b>	
<b>1</b>	1	Ambulanca Banaj	Berat/Poshnje
		<b>QARKU ELBASAN</b>	
		<b>RRETHI ELBASAN</b>	
<b>2</b>	1	Lagjia - Br. 17 S	Elbasan
<b>3</b>	2	Lleshan	Elbasan/Gjinar
		<b>QARKU KORÇË</b>	
		<b>RRETHI KORCE</b>	
<b>4</b>	1	Ambulance Plase	Korce / Pojan
		<b>RRETHI DEVOLL</b>	
<b>5</b>	1	Ambulanca Trestenik	Devoll
<b>7</b>		<b>RAJONI VLORË</b>	
		<b>QARKU VLORË</b>	
		<b>RRETHI VLORE</b>	
<b>1</b>	1	Q/Orikum	Vlore/Orikum
		<b>RRETHI DELVINË</b>	
<b>2</b>	1	Ambulanca Blerimas	Delvine/Finiq
		<b>RRETHI SARANDË</b>	
<b>3</b>	1	Borsh	Sarande/Lukove
<b>4</b>	2	Qsh Vrinë	Sarandë/ Xarre
		<b>QARKU GJIROKASTËR</b>	
		<b>RRETHI GJIROKASTËR</b>	
<b>5</b>	1	Picar	Gjirokaster/Picar
<b>6</b>	2	QSH Libohovë	Gjirokastër / Libohovë
		<b>RRETHI PËRMET</b>	
<b>7</b>	1	QSH Ballaban	Permet/ Ballaban



## 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formulari i ofertës sipas Shtojcës 1*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

*sipas Kriteve të Përgjithshme të kualifikimit.*

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të Lotit 2 objekt prokurimi për të cilin konkurron**. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

### 2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

#### 2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, konkretisht në vlerën **19,111,897.62** (nëntëmbëdhjetë milion e njëqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë.62) lekë pa tvsh dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose,
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, konkretisht: **76,447,590.48** (shtatëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë.48) lekë pa tvsh.

#### **Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpermendura e ben ofertën të kualifikueshme.**

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

***Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.***

### 2.3.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- c) Për kontrata të realizuara me **ente publike**, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
  - Kontratë Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Aktin e kolaudimit;
  - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
- d) Për kontrata të realizuara me **sektorin privat**, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
  - Kontrate Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Aktin e kolaudimit;
  - Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
  - Fatura tatimore perkatese.

#### **SHENIM:**

*Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:*

- *Marreveshjen e bashkëpunimit të operatoreve ekonomik si dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit.*

*Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:*

- *Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor (NE RAST SE KA QENE E PERCAKTUAR NE KONTRATE MIRATIMI).*

### 2.3.3 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

Bazuar në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

#### **PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI**

- NP – 1A (Punime germimi ne toke)
- NP – 3A (Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada)
- NP – 7A (Ujssjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje)

#### **PUNIME SPECIALE NDERTIMI**

- NS-1A (Punime per prishje te ndertimeve)
- NS-2A (Impjante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre)
- NS-4A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese)
- NS-14A (Impjante te brendshme elektrike, telefonike, radiotelefon TV)

Operatorët e huaj duhet të paraqesin njehsimin e licencave profesionale që disponojnë (të lëshuara nga vendi i origjinës), pranë Ministrisë së Energjitikës dhe Infrastrukturës në plotësimin e Licencave Profesionale të kërkuara për ekzekutimin e Kontratës.

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve për periudhën **Shkurt 2022** të jetë jo më i vogël se **45 punonjës në muaj** (përfshirë dhe stafin drejtues teknik dhe stafin me certifikate IQT ose e barazvlefshme), të vërtetuar me:

c. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën **Shkurt 2022**

d. List - pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Shkurt 2022**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

**Shenim:** Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

**2.3.5** Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të deklarojnë drejtuesit teknik për këto vepra, të punësuar për periudhën e kërkuar **Shkurt 2022**, të cilët duhet të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt sipas grafikut të punimeve të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV:

- Inxhinier Ndërtimi
- Inxhinier Mekanik/ Inxhinier H/teknik
- Inxhinier Elektrik

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, sipas punimeve që merr për siper të realizojë referuar Preventivit të punimeve, secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin/t Teknik të punimeve në objekt, të cilët duhet të jetë të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera dhe të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

**Shenim:** Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas

përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

**2.3.6** Operatori ekonomik pjesmarres duhet të deklarojë inxhinierin e ndertimit, që do të jetë në kantier sipas grafikut të punimeve:

Per rajonin Elbasan: 1 inxh.ndertimi;

Per rajonin Vlore: 1 inxh.ndertimi;

Per secilin prej ketyre inxhinierëve të kantierit sipas pikës 2.3.6 duhet të paraqiten kontratat e punës brenda afatit të vlefshmerisë së këtij objekti, diplomat dhe cv.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

**Shenim:**

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar**, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

**2.3.7.** Të ketë në stafin e punonjesve të pasqyruar në list-pagesa:

punonjës të pajisur me deshmë kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI (ish –IQT) ose ekuivalente me të, të vlefshme:

min 2 (dy) teknik ndërtimi; min 3 (tre) punonjës elektrikist; min 3 (tre) punonjës hidraulik/mekanik; min 3(tre) punonjës murator; min 3 (tre) punonjës pllakashtrues; min 3 (tre) punonjës bojaxhi; min 2(dy) punonjës hidroizolues, min 2 (dy) suvatues; - min 2(dy) punëtor d/alumini; - min 2 (dy) punëtor cmontimi dyer,dritare;

Per punonjesit e siperpermendur të paraqiten deshmte perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik si dhe kontrata e punes (te vlefshme).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

**Shenim:**

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar**, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-

së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “**Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin**”.

**2.3.8** Shoqeria duhet të paraqesë Certifikatat e cilësisë me poshtë:

- a. Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 9001-2015** (e vlefshme)/ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b. Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2015** (e vlefshme). /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c. Certifikatën **OHSAS 18001**, për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe të sigurisë në punë (e vlefshme)/ ose/ ISO 45001:2018/ose ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave të që merr përsipër të realizojë në akt marrëveshje.

**2.3.9** Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 8)

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
<i>Kamioncine deri 3 ton kapaciteti mbajtes per secilen</i>	<i>5cope</i>	<i>Pronesi ose qira</i>
<i>Kamion per furnizimin me materiale dhe largimin e mbeturinave nga objekti me goma dhe kapacitet mbajtes 5-10 ton dhe vetshkarkues</i>	<i>5 cope</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>
<i>Elektrobetoniere/betoniere per pergatitje betoni dhe llaci ne objekt me kapacitet min 0.3m3</i>	<i>3 copë</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>
<i>Motogenerator me fuqi deri 5kva</i>	<i>6 copë</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>
<i>Matrapik</i>	<i>6cope</i>	<i>Pronesi ose qira</i>
<i>Nivelues betoni</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronesi ose qira</i>

<i>ekskavator goma ose zinxhir 0.25 m<sup>3</sup></i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronesi ose me qira</i>
<i>Depozita uji 1.000 lt</i>	<i>6 cope</i>	<i>Pronesi ose me qira</i>
<i>Prerese pllakash</i>	<i>6 cope</i>	<i>Pronesi ose me qira</i>
<i>Pompe suvatimi</i>	<i>6 cope</i>	<i>Pronesi ose me qira</i>

**Për të dëshmuar këtë, Formulari i shtojcës 8 të DST Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:**

- Për mjetet motorike, nëse janë në pronësi duhet të paraqiten faturat e blerjes ose të zhdoganimit të tyre.
- Për mjetet motorike, nëse janë me qera, duhet të paraqiten kontratat e qerave ku afati i marrjes me qera të mbulojë afatin e përfundimit të punimeve të objektit dhe faturat e blerjes ose të zhdoganimit të tyre.
- Për mjetet motorike që shënohen në regjistra publike, nëse janë në pronësi, duhet paraqitur dokumenti që vërteton **regjistrimin (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit vjetor**. Për mjetet motorike që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qera, duhet paraqitur dokumenti që vërteton **regjistrimin (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit vjetor, dhe kontrata e qerasë e cila duhet të mbulojë** afatin e përfundimit të punimeve të objektit.
- Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes, ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.
- Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera, duke patur parasysh përdorimin e tyre sipas grafikut të punimeve. Për të vërtetuar këtë duhet të sjellë një vetedeklarim.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

*Shenim:*

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar**, ku parashikohet : “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “**Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin**”.

**PJESMARRJA NË MË SHUMË SE NJË LOT:**

- Nese nje operator ekonomik konkuron ne me shume se **1 lot** te kesaj procedure prokurimi atehere ai duhet te zoteroje kapacitetet e nevojshme dhe te mjaftueshme per te realizuar objektin e procedures se prokurimit, pra te gjitha loteve se bashku. Ne kete kuptim edhe kriteret e vecanta per kualifikim si: pika 2.1.1, pika 2.3.1 të kapacitetit teknik si dhe kategorite e licensave, nr. i punonjesve, i mjeteve, etj. duhet te plotesohen nga operatori ekonomik ne varesi te **shumatores së loteve për të cilat konkurron.**
- Vleresimi mbi kategorite e licences, do te behet me radhe per secilin lot, duke pasur parasysh qe vlera e punimeve qe ka ofertuesi ne proces (perfshire lotin/lotet per te cilet eshte mbyllur vleresimi dhe eshte shpallur fitues ne kete procedure) nuk tejkalon vleren e punimeve sipas kategorive te licences profesionale te ofertuesit.
- Persa i takon licensave, te kihet parasysh qe sipas loteve ku oferton te paraqese kategorite e licensave sipas tabelës së meposhtme:

<b>LOT 1 + LOT 2</b>	<i><b>N.P. 1</b> Punime gërmimi në tokë</i>	<i><b>N.P. 3</b> Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash</i>	<i><b>NP-7</b> Ujesjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vadtije</i>	<i><b>NS-1</b> Punime per prishje te ndertimeve</i>	<i><b>NS 2-</b> Impiante H/sanitare</i>	<i><b>NS 4-</b> Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese)</i>	<i><b>N.S- 14</b> Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV</i>
	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>A</b>	<b>A</b>	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>A</b>

**Shenim për operatorët ekonomik:**

**Shënim:** Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”,

“d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>3</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.” Gjthashtu sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i kapaciteteve sipas **pikave 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7, 2.3.9, të kapacitetit teknik**, do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8) gjatë fazës së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.
- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**



**Shtojca 8.***(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
 \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK**

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik  
(nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Punët/ pajisjet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentacit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni]

<p>kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjisllacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

**B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;	Po [ ]
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po [ ]
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po [ ]
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	Po [ ]
5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:  a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;  b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	Po [ ]
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [ ] Jo [ ]
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).	Po [ ] Jo [ ]

<p>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>	<p>Po [ ] Jo [ ]</p>
<p>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose kërkesat specifike të punëve shërbimeve/apo pajisjeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</p>	<p>Po [ ] Jo [ ]</p>
<p>10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.</p>	<p>Po [ ] Jo [ ]</p>

### C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p>
<p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p>
<p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.</li> </ul> <p>Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut</p>

III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

#### D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
1. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.	Po [ ] Jo [ ]
2. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.	Po [ ] Jo [ ]
3. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.	Po [ ] Jo [ ]

### Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

#### A: DEKLARATË “Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [ ] Jo [ ]

#### B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p> <p><b>Shënim:</b> nëse ofertuesi do të mbështetet edhe në fuqinë punëtore të subjekte të tjera, duhet të deklarojë:</p> <p>Operatori ekonomik _____, do të mbështetet në kapacitetet njerëzore (fuqinë punëtore), të subjektit mbështetës _____, i cili do të vërë në dispozicion _____ punonjës, (me profesionet përkatëse: _____, _____, _____ (nëse është rasti).</p>	<p><b>Punonjës</b></p> <p>Po [ ] Jo [ ]</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve _____</p> <p>Gjithashtu, disponoj personelit kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse:</p> <p>1. Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,</p> <p>2. Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,</p> <p>3. Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,</p> <p><b>Makineri e mjete</b></p> <p>Po [ ] Jo [ ]</p> <p>Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete _____</p>



**C: DEKLARATË “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se zoteroj mjetet pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën.

Mjetet e poshtëshënuara, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk janë të angazhuara në asnjë objekt tjetër dhe do anagzhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.

<b>Në pronësi</b>				
<b>Lloji i Mjetit</b>	<b>Targa</b>	<b>Nr. Lejes qarkullimit</b>	<b>Nr. Shasisë</b>	<b>Të tjera</b>
1				
2				
3				
4				
5				

<b>Me qira</b>					
